



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PUKË
KESHILLI BASHKIAK

Nr. 1157 / 12 prot.

Pukë, më 17.07.2026

VENDIM

Nr. 31 datë 17.07.2026

**PËR
MIRATIMIN E RAPORTIT VJETOR TË PERFORMANCËS SË BASHKISË PUKË
PËR VITIN 2025**

Këshilli Bashkiak Pukë në mbledhjen e tij të datës 17.07.2026, me propozim të Kryetarit të Bashkisë, mbështetur në nenet 15, 18 pika 3 të ligjit nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", i ndryshuar; të ligjit nr.119/2014 "Për të drejtën e informimit", i ndryshuar; të ligjit nr. 68/2017, datë 27.04.2017, "Për financat e vetëqeverisjes vendore", të ndryshuar; të ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, si dhe në kuadër të detyrimit për monitorimin dhe vlerësimin e realizimit të objektivave strategjike, programeve buxhetore dhe treguesve të performancës së Bashkisë Pukë

VENDOSI:

1. Miratohet Raporti Vjetor i Performancës së Bashkisë Pukë për vitin 2025, sipas dokumentit bashkëlidhur këtij vendimi, i cili është pjesë përbërëse dhe e pandashme e tij.
2. Raporti Vjetor i Performancës shërben si dokument zyrtar për vlerësimin e nivelit të realizimit të objektivave strategjike dhe operacionale të Bashkisë Pukë gjatë vitit 2025, të treguesve të performancës së programeve buxhetore, si dhe të efektivitetit dhe eficiencës së përdorimit të burimeve publike.
3. Raporti Vjetor i Performancës për vitin 2025 publikohet në faqen zyrtare të Bashkisë Pukë, në zbatim të legjislacionit për transparencën dhe informimin e publikut.
4. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Ngarkohen Kryetari i Bashkisë, Sekretari i Përgjithshëm, drejtoritë dhe njësitë organizative të Bashkisë Pukë që, në përputhje me fushën e përgjegjësisë së tyre, të marrin masat për zbatimin e rekomandimeve të Raportit Vjetor të Performancës dhe për përmirësimin e vazhdueshëm të performancës institucionale
5. Ky vendim hyn në fuqi SIPAS LIGJIT 139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore", i ndryshuar.
6. Vendimi u shpall me dt.17.07.2026

Vota te vlefshme gjithsej 9

Vota pro 9, Vota kunder 0, Vota abstenim 0.

Sekretari

Ndriçim ASLLANAJ



Kryetari

Gjon GJOKA





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT SHKODËR

Nr. 541/1 prot.

Shkodër, më 22.07.2026

Lënda: Mbi Vendimin nr.31, datë 17.07.2026 të Këshillit të Bashkisë Pukë

KËSHILLI BASHKIAK PUKË

Prefekti i Qarkut Shkodër, në zbatim të detyrave të tij funksionale të përcaktuara në ligjin nr. 107/2016 "Për Prefektin e Qarkut", të ndryshuar, neni 8 shkronja "a", të Urdhërit të Kryeministrit nr. 21, datë 05.02.2025 "Për detyrat e administratës së Prefektit të Qarkut", të Urdhërit të MB nr. 39, datë 20.02.2025 "Për miratimin e rregullores së brendshme "Për organizimin dhe funksionimin e Institucionit të Prefektit të Qarkut", si dhe aneksin 1, "Rregullat për procedurat e verifikimit dhe kontrollin nga Prefekti i Qarkut", të ligjit nr. 139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore", të ndryshuar, neni 44, neni 54, shkronja "n" neni 55, pika 3, të ligjit nr. 68/2017 "Për financat e vetqeverisjes vendore", neni 48, të ligjit nr. 9963, datë 26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, neni 65, të Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr. 22, datë 30.07.2018 "Për procedurat standarte të monitorimit të buxhetit të njesive të qeverisjes vendore", pika 13, të Udhëzimit të MFE nr. 9, datë 20.03.2018 "Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit", shkresës së këshillit bashkiak Pukë nr.1132/4 prot datë 20.07.2026 të Këshillit të Bashkisë Pukë, shqyrtoi VKB-në nr. 31 datë 17.07.2026 "Për miratimin e Planit Vjetor të Përformancës së Bashkisë Pukë për vitin 2025". Pas shqyrtimit, Prefekti ju autorizon procedimin e mëtejshëm.

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin,


PREFEKTI
Holta DUDA
